



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 18.06.2012

Nr. 0201-538

Për: Blerim Kuqi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Vesel Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Lënda: Shkresë ligjore

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar kërkesën Nr.0201-538, të parashtruar nga Grupi Parlamentar i LDK-së në Kuvendin e Komunës së Suharekës, për interpretimin ligjor të vendimeve të Kryetarit të Komunës së Suharekës z.Blerim Kuqi, për emërimin e këshilltarëve politik.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe shtojcën XII të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke u bazuar në leslacionin në fuqi, pas shqyrtimit të hollësishëm të kërkesës në fjalë, **ka konstatuar se;**

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Suharekës për emërimin e tre (3) këshilltarëve politik është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, për faktin se kjo pozitë nuk është parapa me dispozitat ligjore;
- Bazuar në nenin 62.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, drejtorët e drejtorive komunale, i raportojnë rregullisht kryetarit të komunës dhe i ofrojnë të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
- Poashtu në nenin 66 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është përcaktuar se, Administrata komunale organizohet në drejtorate. Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë, **kërkon** nga Kryetari i Komunës që t'i përgjigjet kërkesës për rishqyrtimin e vendimit, për faktin se vendimi në fjalë bie ndesh me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Kosovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović

Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,
Grupit Parlamentar të LDK-së në KK Suharekë,
Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së,
Arkivit të MAPL-së,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 18.06.2012
br. 0201-538

Za: Blerim Kuqi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedavajući Skupštine Opštine

Predmet: Zakonski dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave je primilo zahtev br.0201-538 ,podnešenog od Parlamentarne grupe LDK- Skupštine opštine Suva Reka ,za zakonsko interpretiranje odluka Gradonačelnika opštine Suva Reka g.Blerim Kuqi, za imenovanje političkih savetnika.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu svog mandata određenog prema Zakonu za Lokalnu samoupravu Br.03/L-040, kao i dodatka XII Uredbe 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije premijera i Ministarstava, na osnovu zakonodavstva na snazi,posle detaljnog razmatranja nevedenog zahteva je , *je konstatovalo da je;*

- Odluka Gradonačelnika opštine Suva Reka za imenovanje tri (3) politička savetnika je u suprotnosti sa Zakonom za lokalnu samoupravu br.03/L-040, zbog činjenice da ovaj položaj nije predviđen prema zakonskim dispozicijama;
- Na osnovu člana 62.4 Zakona o Lokalnoj samoupravi, direktori opštinskih direkcija izveštavaju redovno gradonačelnika opštine i daju sve informacije i potrebne izveštaje za proces donošenja odluke;
- Takodje u članu 66 Zakona za lokalnu samoupravu je određeno da opštinska, Administracija se organizuje u direkcije .Svaka opštinska direkcija se menadžira od direktora,koji se imenuje i razrešava od Gradonačelnika opštine .

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određenih prema Zakonu za lokalnu samoupravu br.03/L-040, i na osnovu gore iznetog, *traži* od Gradonačelnika Opštine da odgovori zahtevu za sagledavanje odluke,zbog činjenice da je navedena odluka u suprotnosti sa spovodljivim zakonodavstvom Republike Kosovo

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć za potpuno sprovođenje ovih obavaza koje proizilaze od sprovedljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović

Zamenik premijera & Ministar MALS



Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar,
Parlamentarnoj grupi LDK-u SO Suva Reka,
Direktorima Uprava MALS-e,
Arhivi MALS-e,



LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
DEMOCRATIC LEAGUE OF KOSOVO
DEGA THERANDË/BRANCH THERANDE

Adresa: Rr."Brigada123"Pn. , Tel.029 271 819, www.ldk-theranda.com

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS VLAĐY KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date 22.05.2012			
Niveli organizativ	Nr i Lëndës	Gjyqja	Vlera
- III -	024-538	4	

Për: MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Nga : Grupi parlamentar i LDK-së në Therandë Nr. 05/2012

Lënda: Interpretim ligjor

Grupi parlamentar i LDK-së në Kuvendin Komunal të Therandës kërkon nga titulli i lartëpërmendur interpretim ligjor të vendimeve të Kryetarit të Therandës z. Blerim Kuqi mbi emërimin e këshilltarëve politik.

Kësaj kërkesë ia bashkangjesim kopjet e vendimeve mbi emërimine këshilltarëve politik.

Therandë
21.05.2012



Grupi parlamentar

Shëfket Kolgeci



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKE



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 927

Më datë 31 maj 2010

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 pika (f), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040 dhe nenit 30, nenin 45 paragrafi 1 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë merr këtë:

V E N D I M

Mbi emërimin e këshilltarit politik

Neni 1.

Rexhep Morina i lindur me 07.01.1962 në Samadraxhë, me vendbanim në Prizren, emërohet këshilltar politik i Kryetarit të Komunës në Suharekë për çështje të koordinimit – përfaqësimit me shoqatat e daluar nga Lufta e Kosovës- UÇK-së.

Neni 2.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit politik të Kryetarit të Komunës, i përcakton Kryetari i Komunës me udhëzimet strategjike dhe politike dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 3.

Ky emërim i këshilltarit politik fillon nga data **01 qershor 2010** dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës.

Neni 4.

Për zbatimin dhe implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet dhe zyra e personelit pranë Komunës tonë.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës në Suharekë.

Kryetari i Komunës

Blerim Kuçi


Kopje:

Këshilltar politik
Zyra e personelit
Arxiv





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 121

Më datë 01 shkurt 2010

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58 pika (f), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040 dhe nenit 30, nenin 45 paragrafi 1 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë merr këtë:

V E N D I M

Mbi emërimin e këshilltarit politik

Neni 1.

Hysni Kuçi i lindur me 01.04.1966 në Suharekë, me vendbanim në Rr. "Milit Kryeziu" me profesion fakultetin e kriminalistikës, emërohet këshilltar politik i Kryetarit të Komunës në Suharekë për çështje të sigurisë.

Neni 2.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit politik të Kryetarit të Komunës, i përcakton Kryetari i Komunës me udhëzimet strategjike dhe politike dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 3.

Ky emërim i këshilltarit politik fillon nga data 01 shkurt 2010 dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës.

Neni 4.

Për zbatimin dhe implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet dhe zyra e personelit pranë Komunës tonë.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës në Suharekës.

Kryetari i Komunës

Blerim Kuçi

Kopje:


Këshilltari politik

Zyra e personelit

Arkiv



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 16-1153

Më datë 15 mars 2011

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58, pika (f), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-05 L-040, dhe nenit 30, nenin 45 paragrafi 1 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë merr këtë:

V E N D I M

Mbi emërimin e këshilltarit politik

Neni 1.

Muhamet Bajraktari i lindur me 13.04.1960 në fshatin Bllacë, Komuna e Suharekës, me profesion shkollën e lartë Gjeografike, emërohet, këshilltar politik i Kryetarit të Komunës në Suharekë.

Neni 2.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit politik të Kryetarit të Komunës, i përcakton Kryetari i Komunës me udhëzimet strategjike dhe politike dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 3.

Ky emërim i këshilltarit politik fillon nga data 15 mars 2011 dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës.

Neni 4.

Për zbatimin dhe implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet dhe zyra e personelit pranë Komunës tonë.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës në Suharekë.

Kryetari i Komunës

Blerim Kuçi

Kopje:

Këshilltarit politik
Zyra e personelit
Arkiv